



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 3428 Prot.

Tiranë, më 27 . 11 .2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 556/13 PROT., DATË 04.11.2025 TË INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PA NJË
VENDIM PËRFUNDIMTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA
NGA SHTETASI FIQIRI REXHO”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Fiqiri Rexho, me nr. 229 prot., datë 28.01.2022, nr. 229/1 prot., datë 02.02.2022, nr. 678 prot., datë 01.03.2023, nr 678/2 prot., datë 05.07.2023, nr. 678/3 prot., datë 03.08.2025 nr. 678/5 prot., datë 13.12.2025, nr. 1643 prot., datë 10.06.2024 dhe nr. 1643/2 prot., datë 12.06.2024, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve A.H., I.H., B.S., dhe K.Ll., me detyrë prokurorë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë dhe S.Xh., me detyrë gjyqtare pranë kësaj gjykate, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe me vendimin nr. 556/13 prot., datë 04.11.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi Fiqiri Rexho”, bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja “Isa Boletini”, Bulevardi Vlorë-Skelë, pallati nr. 992, Vlorë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko